



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:024458

Datë: 22.01.2021

Numri i dokumentit: 01435112

**DKR P nr.107/20**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI PËR KRIME TE RENDA**, sipas Kryetares se Trupit Gjykses – Gjyqtares Lumturije Muhaxheri, me pjesëmarrjen e Sekretares Juridike Shpresa Kernja , në çështjen penale ndaj të pandehurve, J. G. nga ....., Rr ..... nr.2 dhe E. A. nga Peja Rr..... nr.45, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Peje -Departamenti i Përgjithshëm kaluar në kompetencë të Departamentit të Krimeve të Rënda PP/II nr.214/2016.02.2020, secili veç e veç për shkak të veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-se dhe veprës penale mbajtja në pronësi , kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, në seancën e shqyrtimit fillestar, publik të mbajtur me dt.28.12.2020, në praninë e Prokurorit të Shtetit – Valbona Disha Haxhosaj , të pandehurve, J. G. dhe E. A. dhe mbrojtësve të tyre avokat Rustem Lajqi dhe Kadri Prekaj që të dy nga Peja , sipas detyrës zyrtare , të njëjtën ditë murr dhe me dt.22.01.2021, përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Ndaj të pandehurve**

**1.J. (G.) G.**, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr....., i lindur me dt....., në ....., me vendbanim në rrugën ,, ..... nr.2. i biri i G. dhe nënës Z. e gjinisë K. , ka të kryer shkollën e mesme teknike , i martuar , baba i tre fëmijëve , me profesion tregtar, i gjendjes së vështirë ekonomike, Shqiptar Shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet në liri .

**2.E. (A.) A.**, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr..... , i lindur me dt....., në ....., me vendbanim në rrugën ,, .....” nr.54. i biri i A. dhe nënës R. e gjinisë K. , ka të kryer shkollën e mesme , i martuar , baba i dy fëmijëve , me profesion autolimar, i gjendjes së vështirë ekonomike, Shqiptar Shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet në liri .

**JANË FAJTOR**

I pandehuri J. G.

**Për shkak se:**

1.Me dt.18.01.2020 rreth orës 17:00 në Fshatin..... ne .... , përdor armen ne kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët dhe atë me nenin 41 dhe 42, ne atë mënyrë i pandehuri ditën kritike merr armen e llojit Pistoletë me gazë ..... kal,8 mm me numër serik ..... prodhim ..... , me te cilën shtënë disa here ne ajër ne vendin dhe kohen e cekur me larte , po me pas hetohet nga Policia e Kosovës.

-me çka ka kryer veprë penale përdorimi i armës apo mjetit te rrezikshëm nga neni 367 par.1 te KPRK-se

2.Ne kohen e pa njohur e gjere me dt.20.01.2020, rreth orës 10.00 ne rr. .... nr.2 ne .... , përkatësisht ne lokalit e tij, i pandehuri J. G.ne kundërshtim me nenin 5 par.1 te Ligjit për arme , mban ne pronësi arme , ne atë mënyrë qe i njëjti pa leje merr ne posedim armen e llojit Pistoletë me gazë ..... kal,8 mm me numër serik ..... prodhim ..... , si dhe një karikator te armës përkatëse te cilat Policia e Kosovës gjate urdhër kontrollit ia gjen dhe i sekuestron ,

-me çka ka kryer veprë penale mbajtja në pronësi , kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

II I pandehuri E. A.

#### **Për shkak se:**

1.Me dt.18.01.2020 rreth orës 17:00 në Fshatin .... ne .... , përdor armen ne kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët dhe atë me nenin 41 dhe 42, ne atë mënyrë qe i pandehuri ditën kritike merr armen e llojit Pistoletë me gazë ..... , kal,9 mm me numër serik ..... , me te cilën shtënë disa here ne ajër ne vendin dhe kohen e cekur me larte , po me pas hetohet nga Policia e Kosovës.

-me çka ka kryer veprë penale përdorimi i armës apo mjetit te rrezikshëm nga neni 367 par.1 te KPRK-se

2.Ne kohen e pa njohur e gjere me dt.20.01.2020, rreth orës 10.00 ne rr. ....45 ne .... , përkatësisht ne punëtorinë e tij , i pandehuri E. A. ne kundërshtim me nenin 5 par.1 te Ligjit për arme , mban ne pronësi arme , ne atë mënyrë qe i njëjti pa leje merr ne posedim armen e llojit Pistoletë me gazë ..... , kal,9 mm me numër serik ..... , si dhe një karikator te armës si dhe një fishek me gaz te kal.9 mm, fotroll, brushe dhe kuti për mbajtjen e njëjtës arme dhe atë pa autorizim , te cilat Policia e Kosovës gjate urdhër kontrollit ia gjen dhe i sekuestron ,

-me çka ka kryer veprë penale mbajtja në pronësi , kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

#### **Në Mbështetje të nenit 76 të KPRK , Gjykata të pandehurve ju përcakton:**

##### **I.T pandehurit J. G.**

1.Për veprën penale nga neni 367 par.1 te KPRK-se, dënimi i shqiptuar me burgim ne kohëzgjatje prej dy muaj me pëlqimin e te pandehurit i është zëvendësuar me dënim me gjobë ne shume prej 200 € (dyqindtë ) euro ,

2.Për veprën penale nga neni 366 par.1 te KPRK-se , dënim me gjobë ne shume prej 200 € (dyqindtë ) euro,

## **2.T pandehurit E. A.**

1.Për veprën penale nga neni 367 par.1 te KPRK-se, dënimi i shqiptuar me burgim ne kohëzgjatje prej dy muaj me pëlqimin e te pandehurit i është zëvendësuar me dënim me gjobë ne shume prej 200 € (dyqindtë ) euro ,

2.Për veprën penale nga neni 366 par.1 te KPRK-se , dënim me gjobë ne shume prej 200 € (dyqindtë ) euro

**Gjykata me aplikimin e dispozitave ligjore nga neni 4, 7, 17 par.1, 21 par.2, 38, 43, 44, 69, nenin nenit 71 par.1 pika 1.3, nenit 76 ,nenit 366 par.1 dhe 3 nenit 367 par.1 të KPRK-së, nenit 365, 366, të KPPRK-së, të pandehurit , i**

## **G J Y K O N**

### **Te pandehurin J. G.**

Me **DËNIM UNIK ME GJOBË** në shumë prej 400 € (katërqind ) euro, të cilën shumë është i detyruar ta paguajë në afat prej 90 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, e në rast të mos pagimit të dënimit me gjobë, i njëjti do të zëvendësohet me dënim me burgim në kohëzgjatje, prej (20 ) ditësh, ashtu që çdo 20 € (njëzet) euro, të dënimit me gjobë, i përcakton një ditë burg.

Të pandehurit i konfiskohet një pistoletë me gazë ..... kal,8 mm me numër serik ..... prodhim Italian , si dhe një karikator te armës përkatëse dhe urdhërohet shkatërrimi i saj, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, numri rastit në polici 2020-DA-0119, të dt. 25.01.2020.

I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjyqësorë gjykatës ti paguaj shumën prej 20 (njëzetë) € euro, si dhe taksa shtesë në emër të programit për kompensimin e viktimave të paguaj shumën prej 50 (pesëdhjetë) € euro, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

### **Te pandehurin E. A.**

Me **DËNIM UNIK ME GJOBË** në shumë prej 400 € (katërqind ) euro, të cilën shumë është i detyruar ta paguajë në afat prej 90 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, e në rast të mos pagimit të dënimit me gjobë, i njëjti do të zëvendësohet me dënim me burgim në kohëzgjatje, prej (20 ) ditësh, ashtu që çdo 20 € (njëzet) euro, të dënimit me gjobë, i përcakton një ditë burg.

Të pandehurit i konfiskohet një pistoletë me gazë ....., kal,9 mm me numër serik ....., si dhe një karikator te armës si dhe një fishek me gaz te kal.9 mm, fotroll, brushe dhe kuti për mbajtjen e njëjtës arme dhe urdhërohet shkatërrimi i saj, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, numri rastit në polici 2020-DA-0119, të dt. 25.01.2020.

I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjyqësorë gjykatës ti paguaj shumën prej 20 (njëzetë) € euro, si dhe taksa shtesë në emër të programit për kompensimin e viktimave të

paguaj shumën prej 50 (pesëdhjetë) € euro, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore ne Peje - Departamenti për Krime te Renda , ka ngrit aktakuzë, PP/II nr.214/20 të datës 16.02.2020, ndaj të pandehurve, J. G. nga ....., Rr ..... nr.2 dhe E. A. nga .... Rr..... nr.45, për secilin veç e veç për veprën penale përdorimi i armës apo mjetit te rrezikshëm nga neni 367 par.1 te KPRK-se dhe veprës penale mbajtja në pronësi , kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.,

Para leximit te aktakuzës , prokurori i shtetit deklaroi se e bene korrigjimin e dispozitivit ashtu qe ne raport me dy te pandehurit lidhur me veprën penale nga neni 367 par.1 te KPRK-se ne rreshtin e fundit ku është shënuar „gjate një ahengu,, nuk duhet te ekzistoj, por duhet te jete ne vendin dhe kohen e larte cekur ka shtënë disa here ne ajër, pjesa tjetër e dispozitivit mbetet e pa ndryshuar.

Pas leximit te aktakuzës dhe modifikimit te saj, në seancën e shqyrtimit fillestar, Gjykata duke vepruar në kuptim të nenit 246 par.4 të KPPK-se, të pandehurve secilit veç e veç ju ka dhënë mundësinë që të deklarohen për pranimin ose mospranimin e fajësisë. Me këtë rast, Gjykata, edhe një herë i ka udhëzuar të pandehurit për rëndësinë dhe pasojat e pranimin të fajësisë në kuptim të nenit 248 par.1 pika 1.1, 1.2, 1.3 të KPPK-se, kështu që te pandehurit secili veç e veç kane deklaruar se janë plotësisht te vetëdijshëm për rëndësinë e pranimin të fajësisë duke shtuar se deklarimi i tyre paraqet shprehje të vullnetit të tyre të lirë, pasi që ata janë kryes te veprave penale ,të cilën nuk kane si ta mohojnë, e pranojnë në tërësi fajësinë për veprat penale për të cilat janë akuzuar , dhe se pranimi i fajësisë nga ana e tyre është i mbështetur edhe në provat të cilat i janë ofruar gjykatës me aktakuzë, të njëjtëve ju vie keq dhe shprehin pendim për rastin dhe se ne te ardhmen nuk do ti përsërisin veprimet e tyre..

Pas deklarimit të pandehurve për pranimin e fajësisë, Kryetarja e trupit gjykues, kërkoi mendimin e vet për këtë ta japin prokurori i shtetit dhe mbrojtësit e te pandehurve .

Prokurori i Shtetit-Valbona Disha Haxhosaj , në këtë drejtim deklaroi, se pajtohet me pranimin e fajësisë nga te pandehurit, me qe pranimi i fajësisë nga te pandehurit ishte i vullnetshëm pa presion dhe i bazuar ne prova ne baze te cilave është ngritur akuza , andaj i propozoi gjykatës qe për secilin te pandehur veç e veç ta aprovoj pranimin e fajësisë.

Mbrojtësit e te pandehurve avokat av. Rustem Lajqi dhe Kadri Prekaj ne këtë drejtim deklaruan , me qe te mbrojturit e tyre e pranuan fajësinë për veprat penale qe ju vihen ne bare dhe me qe ky pranim i tyre i fajësisë është bere ne mënyrë te vullnetshme dhe pa presion, i propozojnë gjykatës qe pranimin e fajësisë nga te mbrojturit e tyre ti aprovon , dhe me rastin e marrjes se vendimin mbi dënim gjykata pranimin e fajësisë ta vlerësoj si rrethane veçanërisht lehtësuese.

Në vijim, Gjykata duke e shqyrtuar pranimin e fajësisë, nga ana e të pandehurve, vlerësoi se pranimi i fajësisë paraqet shprehje të vullnetit të lirë të pandehurve, pasi që ata e kane kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë dhe pranimi i fajit është bërë në mbështetje të fakteve të prezantuara në aktakuzë, në përputhje me kërkesat e nenit 248 par.1 pika 1.1, 1.2, 1.3 të KPPK-së, bazuar ne te lartcekurat gjykata pranoi pranimin e fajësisë nga te pandehurit për secilin veç e veç , për shkak te veprave penale “ Përdorimi i armës apo mjetit te rrezikshëm nga

neni 367 par.1 të KPRK-se dhe veprës penale mbajtja në pronësi , kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së .

Me faktet e ofruara si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit.

Nga gjendja e vërtetuar faktike, siç është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurve secilit veç e veç , qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale “Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-se dhe veprës penale Mbajtja në pronësi , kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Sa i përket fajësisë, Gjykata ka gjetur se tek të pandehurit ka ekzistuar dashja që veprat penale ti kryejnë në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, pasi që të pandehurit kanë qenë të vetëdijshëm për veprat e kryera dhe e kanë dëshiruar kryerjen e tyre.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të pandehurve, kështu që të njëjtit janë penalisht përgjegjës.

Duke pas parasysh se Gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve në shqyrtimin fillestar, ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 253 par.1 pika 1.1, 1.2, 1.3 të KPPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushtet nga neni 248 par. 4 të KPPRK-së, dhe bazuar në mendimin juridik të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës Prishtinë dhe, Gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të EULEX-it, me nr.GjA.nr.207/13 dt.19.03.2013, në këtë çështje penale nuk është mbajtur seanca e dytë e as ajo e shqyrtimi gjyqësor, një herit edhe me rastin e shpalljes së të pandehurit fajtor dhe shqiptimin e dënimit nuk është plotësuar fare trupi gjykues.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, Gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 69 par.1 të KPRK-se. Kështu si rrethana lehtësuese për të dy pandehurit, Gjykata ka vlerësuar faktin se të njëjtit kishin sjellje korrekte gjatë procedurës penale, janë penduar për veprat penale duke i premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisin veprimet e tyre , për të pandehurin Jeton se është i martuar dhe baba i tre fëmijëve, kurse i pandehuri Emir i njëjti është i martuar dhe baba i dy fëmijëve , të gjitha këto Gjykata i ka pranuar si rrethanë favorizuese, Si rrethanë tjetër posaçërisht lehtësuese, për të dy të pandehurit gjykata e merr faktin se të njëjtit në shqyrtimin fillestar e kanë pranuar fajësinë për veprat penale për të cilat pandehen, gjë që dëshmuar gatishmëri për bashkëpunim me organin e akuzës dhe me gjykatën, dhe kjo sipas vlerësimit të gjykatës paraqet pendim të sinqertë të tyre dhe fillim të procesit të rehabilitimit të tyre, Andaj në prezencën e këtyre rrethanave lehtësuese , e në mungesë të ndonjë rrethane rënduese, të pandehurit secilin veç e veç komfor nenit 71 par.1 pika 1.3 të KPRK-së për veprën penale nga neni 267 par.1 i gjykoi nën minimum ligjore , kurse për veprën penale nga neni 366 par.1 i gjykoi në suaza ligjore , si në dispozitiv të këtij aktgjykimi me të cilën do të arrihet edhe qëllimi i dënimit.

Duke i vlerësuar kështu të gjitha rrethanat e parashikuar me nenin 69 par.1 të KPRK-se, Gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të pandehurve është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tyre dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbejë për arritjen e qëllimit të dënimit në pengimin e të pandehurve në kryerjen e veprave penale në të ardhmen por ai do të

ndikoj edhe si preventive gjenerale për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale në përputhje me nenin 38 të KPRK-se .

Vendimi për konfiskimin dhe asgjësimin e armëve , të përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, është marr në kuptim të nenit 366 par.3 të KPRK-se.

Vendimi që të akuzuarve secilit veç e veç, dënimet e shqiptuara me burgim me pëlqimin e tyre gjykata ju zëvendësoi me dënime me gjobe, është marr në kuptim të nenit 44 të KPRK-se.

Vendimi mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor është i bazuar në lartësinë reale të shpenzimeve të shkaktuara për zhvillimin e këtij procesi penal, prandaj gjykata duke u bazuar në nenin 450 të KPRK-se të pandehurin e obligoi në pagimin e shpenzimeve të paushallit gjyqësor.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë komform nenit 39 par.3 nën par. 3.2 të Ligjit nr. 05/L-036

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 365 të KPPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Duke u bazuar në nenin 368 par.2 të KPPK-se, Gjykata palët në procedurë i njoftoi me paralajmërimet që shoqërojnë aktgjykimin.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË - DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RENDA,  
DKR P.nr.107/20 dt.28.12.2020, i përpiluar me dt.22.01.2021**

**Sekretarja Juridike :  
Shpresa Kernja**

**Kryetarja e Trupit Gjyqësor :  
Lumturije Muhaxheri**

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së aktgjykimit. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2020:024458  
Datë: 22.01.2021  
Numri i dokumentit: 01435112